


**BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.



Prishtinë, më 16.04.2026

**Lënda:** Propozim për amendimin e Vendimit të Bordit të ZRrE nr. V\_1768\_2023, datë 21.09.2023 “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”.

**Drejtuar:** **ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
Rruga: Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, Prishtinë 10000.

**I nderuar z. Fejzullahu,**

Në zbatim të Vendimit të Bordit të ZRrE nr. V\_1638\_2022, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, të ndryshuar me vendimin e ZRrE nr. V\_2586\_2024, datë 06.12.2024, Vendimit të Bordit të ZRrE nr. 1768\_2023, datë 21.09.2023 “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”, si dhe Vendimit të Bordit të ZRrE nr. V\_1748\_2023, datë 17.07.2023 “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, ju bëjmë me dije se:

Siç edhe jeni në dijeni ALPEX aktualisht operon si treg i bashkuar ndërmjet të dy Zonave të Ofertimit Shqipëri – Kosovë duke filluar për Tregun e Ditës në Avancë (DAM) që prej Ditës së Livrimit 01.02.2024 si dhe në Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë (IDA) që prej Ditës së Livrimit 12.12.2024. Gjatë operimit të kësaj periudhe siç edhe shprehet në Vendimin përkatës të Bordit të ERE nr. 139, datë 14.04.2023 “Veç sa më sipër, meqenëse Bursa e Energjisë Elektrike momentalisht është funksionale vetëm në zonën e ofertimit në Shqipëri, këto kufij do të shërbejnë vetëm për këtë zonë dhe jo për bashkimin e tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Në momentin që do të bëhet operacionale Bursa e Energjisë Elektrike për zonën e ofertimit të Kosovës dhe shoqëria ALPEX sh.a., do të vlerësojë se këto kufij do të jenë ende të nevojshëm, atëherë do të paraqesë për miratim kufijtë edhe për zonën e bashkimit të tregjeve të cilët do të jenë objekt i miratimit nga autoritetet rregullatore të të dyja vendeve”.

Në vijim të sa përmendur më lart si dhe në monitorim të vazhdueshëm të performancës së tregjeve që aktualisht operojmë, trendit rajonal dhe me gjerë, por duke marrë në konsideratë edhe faktorët që përmenden më poshtë sipas viteve si vijon:

Viti 2024:

A. Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Minimum Price Threshold)

ALPEX ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Minimal në vetëm 2 raste në mënyrë që tu japë mundësi Anëtarëve të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë dhe në të 2 këto raste nuk ka prodhuar rezultat, pra nuk kemi pasur përmirësim të rezultatit të zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë, çmimet e dala kanë vijuar të mbeten në të njëjtat nivele si në ankandin normal.

B. Kufiri maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum Price Threshold)

ALPEX ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Maksimal në 49 raste në mënyrë që tu japë mundësi Anëtarëve të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë dhe në thuajse të gjitha rastet (hiq vetëm 2 raste për të cilat jani informuar) kemi pasur përmirësim të rezultatit të zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë, çmimet e dala pas këtij ankandi kanë qenë brenda kufijve të vendosur.

Viti 2025:

A. Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Minimum Price Threshold)

ALPEX nuk ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Minimal gjatë këtij viti.

B. Kufiri maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum Price Threshold)

ALPEX ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Maksimal në 3 raste në mënyrë që tu japë mundësi Anëtarëve të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë dhe në të gjitha rastet kemi pasur përmirësim të rezultatit të zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë, çmimet e dala pas këtij ankandi kanë qenë brenda kufijve të vendosur.

Viti 2026 (Janar 2026 – 15 Mars 2026):

A. Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Minimum Price Threshold)

ALPEX ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Minimal në 12 raste në mënyrë që tu japë mundësi Anëtarëve të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë dhe në të 12 këto raste nuk ka prodhuar rezultat, pra nuk kemi pasur përmirësim të rezultatit të zgjidhjes së Algoritmit të Përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë, çmimet e dala kanë vijuar të mbeten në të njëjtat nivele si në ankandin normal.

**B. Kufiri maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum Price Threshold)**

ALPEX nuk ka aktivizuar mekanizmin e Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Maksimal gjatë kësaj periudhe.

Pra, në përmbledhje të sa përmendur më lart si dhe në monitorim të vazhdueshëm të ecurisë si të tregjeve të ALPEX, por edhe të rajonit si dhe ato evropiane kemi vënë re që shumë prej bursave kanë pasur çmime negative si dhe në rastet e ALPEX kemi parë që në disa prej urdhërporosive kemi çmime negative të vendosura nga Anëtarët e Bursës çka besojmë se reflektojnë edhe trendin e bursave rajonale në të cilat këta Anëtarë operojnë, por edhe duke marrë parasysh që thuajse në të gjitha rastet që është aktivizuar mekanizmi i Ankandit të Dytë si pasojë e arritjes së Kufirit Minimal të Lejuar për Ankandin e dytë, 0 €/MWh, nuk kemi parë ndërhyrje të Anëtarëve për të përmirësuar zgjidhjen e Algoritmit, e kundërta me arritjen e Kufiri maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë në të cilin në thuajse të gjitha rastet kemi pasur përmirësim të rezultatit të zgjidhjes së Algoritmit, si dhe duke marrë parasysh edhe kohën në operim nga ALPEX, por edhe eksperiencën e Anëtarëve të Bursës të përfaqësuar nga Agjentët Tregtarë të Certifikuar nga ALPEX, propozojmë para jush si vijon:

Ishte:

- Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum Price Threshold) të jetë: **+ 900 €/MWh.**
- Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Minimum Price Threshold) të jetë: **0 €/MWh.**

Bëhet:

- Kufiri Maksimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Maximum Price Threshold) të jetë: **+ 900 €/MWh.**
- Kufiri Minimal i Lejuar i Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (Minimum Price Threshold) të jetë: **- 50 €/MWh.**

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim në kuadër dhe funksion të amendimeve të propozuara.

Me respekt,

**Drejtor Menaxhues i ALPEX sh.a – Dega në Kosovë**

**Sokol Dishnica**

Për: 